



Titulli i projektit

Ndërtim i rrugëve lidhëse të qendrave të banuara me bregun e Liqenit të Shkodrës

Tipi i projektit

Shërbimet publike/Sektori strategjik i turizmit

Vendndodhja e projektit

NJVQ Qendër, Gruemirë, Koplík, Kastrat

Buxheti i paravlerësuar

N/A

Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve

Projekti për ndërtimin e rrugëve lidhëse të qendrave kryesore të banuara të zonës funksionale Malësi e Madhe me liqenin e Shkodrës i drejtohet nevojës për të ngritur infrastrukturën rrugore të zonës funksionale. Kjo nevojë është nxjerrë në pah në analizën e shërbimeve publike të Programit të Zonës Funksionale, si një nga mangësitë kryesore që përcaktojnë standardin e jetesës së tanishme të banorëve dhe që lidhet ngushtë me mundësitë për shfrytëzimin e potencialit të të ardhurave nga turizmi liqenor. Gjithashtu, ndërtimi i rrugëve lidhëse është i nevojshëm për të mbështetur paketat që përfshijnë një tërësi pikash turistike, që zgjaten nga pjesa liqenore deri në atë malore të zonës funksionale.

Qëllimi/et specifik të projektit

Objekti i këtij projekti është ngritja e infrastrukturës rrugore të nevojshme për shtimin e lëvizjes së banorëve të zonës funksionale drejt liqenit të Shkodrës, duke krijuar mundësinë e tërheqjes së vizitorëve në zonë, si dhe dendësuar bashkëveprimin mes qendrave të banuara për qëllime ekonomike dhe sociale.

Rezultatet e pritshme dhe treguesit

Rezultatet e pritshme të projektit janë:

- Rrugë të asfaltuara të cilat lidhin me bregun e liqenit të Shkodrës qendrat dhe fshatrat e njësjive vendore Qendër, Gruemirë, Kastrat e Koplík (një popullsi rreth 42000 banorë ose 77 % e popullsisë së Malësisë së Madhe).
- Shtimi i dendësisë së lëvizjeve të këtyre banorëve drejt bregut të liqenit të Shkodrës.
- Shtimi i numrit të vizitorëve për turizëm liqenor në zonën funksionale Malësi e Madhe.

PROJEKTI 11



program i zonave funksionale

pzf

Aktivitetet e projektit

Projekti mund të zhvillohet sipas fazave të mëposhtme të punimeve:

- Rikonstruksion i shtresave të rrugës, vendosja e shtresave të asfaltit;
- Punime elektrike për ndriçimin e rrugës;
- Vendosja e sinjalistikës rrugore (tabela turistike).

Maturimi i projektit

Projekti për ndërtimin e rrugëve lidhëse të qendrave të banuara të zonës fushore të Malësisë së Madhe me liqenin e Shkodrës është një ide për të zgjidhur nevojën e plotësimit të zonës me infrastrukturën bazë rrugore.

Realizimi i kësaj ideje është një ndër masat për ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme për të nxitur zhvillimin e sektorit të turizmit në zonën funksionale.

Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Donatorë të mundshëm të projektit janë: buxheti i qeverisë qendrore, buxheti i qeverisë vendore dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Këta donatorë janë evidentuar si të mundshëm, meqenëse fokusi i tyre lidhet ndër të tjera me zhvillimin e infrastrukturës vendore me synim promovimin e mëtejshëm të turizmit.

Kostot e projektit

Në bazë të listës së rrugëve të Financuara nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit 2005-2013, për ndërtim rruge në zona të ulta në veri të vendit, mund të përafrojmë një kosto ndërtimi rreth 4,000,000 lekë/km ose rreth 28,000 EUR/km.